

Në bazë të nenit 52 paragrafit (3) të Ligjit për Arsimin Filor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19 dhe 229/20), Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

K A L E N D A R
PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E SHKOLLAVE FILLORE
NË VITIN SHKOLLOR 2023/2024

Neni 1

Me këtë Kalendar përcaktohet organizimi i vitit shkollor në shkollat fillore në pajtueshmëri me njësitë programore në vitin shkollor: gjysmëvjetori, forma të tjera të veprimtarisë edukativo-arsimore dhe pushimet e nxënësve për vitin shkollor 2023/2024.

Neni 2

Viti shkollor në shkollat fillore fillon më 1 shtator 2023 dhe përfundon më 30 gusht 2024.
Viti shkollor fillon më 1 shtator 2023 dhe përfundon më 17 qershor 2024.

Neni 3

Viti shkollor përbëhet nga dy gjysmëvjetorë - gjysmëvjetori I dhe II.
Gjysmëvjetori i parë fillon më 1 shtator 2023 dhe përfundon më 29 dhjetor 2023.
Gjysmëvjetori i dytë të fillojë më 22 janar 2024 dhe të përfundojë më 17 qershor 2024.

Neni 4

Gjatë vitit shkollor nxënësit i shfrytëzojnë pushimet dimërore, pranverore dhe verore.
Pushimi dimëror fillon më 30 dhjetor 2023 dhe përfundon më 19 janar 2024.
Gjatë pushimeve dimërore, punonjësit në shkollë prej më 2 janar 2024 deri më 12 janar 2024 shfrytëzojnë ditë pune me pagesë.
Pushimi pranveror fillon më 29 prill dhe përfundon më 6 maj 2024.
Pushimi veror fillon më 18 qershor 2024 dhe përfundon më 31 gusht 2024.

Neni 5

Shkolla fillore prej më datë 18 qershor deri më 1 korrik 2024, organizojnë mësim plotësues, provime korigjuese dhe provime të klasës, ndërsa prej më datë 15 gusht deri më 21 gusht 2024 organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera ndihmëse për nxënësit të cilët duhet t'i nënshtrohen provimeve korigjuese dhe provimeve të klasës dhe të njejtat t'i zbatojnë .

Neni 6

Puna edukativo-arsimore për nxënësit organizohet përgjatë javës së punës.

Neni 7

Në vitin shkollor 2023/2024 mësimi realizohet në 180 ditë mësimore.

Neni 8

Në ditën e shkollës organizohen ngjarje kulturore, sportive dhe manifestime të tjera.
Dita tradicionale e arsimit për pjesëtarët të përkatësive të cilët ndjekin mësimin në gjuhë të

ndryshme nga gjuha maqedonase shënohet me organizimin e manifestimeve kulturore dhe të tjera.

Dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimimit për pjesëtarët e bashkësive të cilët mësimin e ndjekin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë ditë mësimore kur realizohen programe të veçanta, për manifestimet të paragrafit 1 dhe 2 të këtij Neni.

Neni 9

Ditët e punës kur realizohen ekskursionet e nxënësve, dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimimit për pjesëtarët e bashkësive të cilët mësimin e ndjekin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë ditë mësimore kur realizohen programe të veçanta.

Për nxënësit të cilët nuk i ndjekin ekskursionet e nxënësve, shkolla organizon mësim të rregullta në pajtueshmëri me orarin e orëve mësimore.

Neni 10

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij kalendari pushon së vlefshmi Kalendari për organizimin e vitit shkollor 2022/2023 në shkollat e mesme publike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 178/22 dhe 6/23).

Neni 11

Ky kalendar hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 shtatori 2023.

Nr. 18-8242/1

03.08.2023

Shkup

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Doc. Dr. Jeton Shaqiri, d.v.